

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtaren Franciska Zhitia-Ymeri duke vendosur lidhur me çështjen juridike të paditësit N.P.T“U.” me seli në P. rruga “...” fshati Ll. S. të cilin e përfaqësoj sipas autorizimit me shkrim A. S. avokat nga P., ndaj të të paditurës P. C. B.sh.a, me seli në P., të cilin e përfaqësoj sipas autorizimit me shkrim S. S. avokate nga P., për shkak të anulimit të kontratës dhe kthimi e të hollave në vlerën prej 12,217.36 euro, në seancën e shqyrtimit kryesor të datës; 21.09.2015, ndërsa pas marrjes së fjalës përfundimtare nga palët ndërgjyqëse, me datën; 19.10.2015 merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. Refuzohet në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit N.P.T“U.” me seli në P. me të cilën ka kërkuar anulimin e kontratës me nr.CA-0308 e datës 24.10.2011 dhe ta detyroi të paditurën P. C. B. sh.a me seli në P. që t’ia kthej vlerën e konfiskuar në shumë prej 12,217.36 euro, dhe kompenzimin e dëmit si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Detyrohet që pala paditëse N.P.T“U.” me seli në P. që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t’ia paguaj të paditurës P. C. B. sh.a me seli në P. shumën e përgjithshme prej 1,226.00 euro.

A r s y e t i m

Paditësi N.P.T“U.” me seli në P. , ka parashtruar pranë kësaj gjykate padi me datën 18.07.2013 ndaj palës së paditur P. C. B. sh.a me seli në P., duke kërkuar që e paditura t’ia kthej vlerën e konfiskuar në shumë prej 12.217.36 euro dhe anulimin e kontratës me nr.CA-0308 e datës 24.10.2011 si dhe kompenzimin e dëmit dhe njëherit i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

I autorizuar i të paditurit si në përgjigje në padi dhe në seancat e mbajtura ka kontestuar në tërësi kërkesëpadin e paditësi si të pabazuar sepse e paditura është mbështetur në kontratën për dorëzani e cila është e nenshkruar nga te dy palët në procedurë dhe njëherit ka kërkuar që kërkesëpadin e paditësi ta refuzoi të pa bazuar .Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata ka administruar këto prova si në vijim: kontrata për kredi me nr.10-079457 e dt.25.10.2011, kontrata mbi pengun e dt.25.10.2011, kontrata për dorëzani e dt.2.10.2011, certifikata e biznesit NPT“U.”, lëvizja në llogarinë nga data 01.07.2014 deri më datën 14.07.2014, gjendja e paditësit nga data 01.07.2014, deri me datë 14.11.2013, ndëgjimi i dëshmitarit H. B..

Pas shqyrtimit të detajuar të provave të administruara, shkresave të lëndës, thëniet e palëve, duke e bërë vlerësimin e secilës provë vec e vec dhe të gjithave së bashku, në vështrim të nenit 8 të LPK-së, gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditësit në tërësi është e pabazuar.

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se palët kanë qenë në marrëdhënie detyimore kontraktuese sipas kontratës për dorëzani, por ishte kontestuese fakti se paditësi pretendon se kontratën nuk e ka nënshkruar në emër NTP U. dhe se e paditura në mënyrë të njëanshme ja kishte konfiskuar të hollat në vlerë prej 8.536.42 euro .

Nga kontrata për dorëzani e datës 25.10.2011 gjykata vërtetoi faktin se paditësi si dorëzan ishte pajtuar të jetë si dorëzan për detyrimet ndaj kredithënësit – tani paditurës që ka kredimarrësi NPSH S. me seli në P.. Në nenin 1 të kontratës është paraparë që dorëzani ka marrë për detyrim që ta paguaj shumën prej 32.646.90 euro për periudhën kohore prej 60 muaj duke përfshirë edhe kamatën dhe ndëshkimet. Në këtë kontratë tani paditësi kishte cilësinë e garantuesit për përmbushjen e kredisë dhe në bazë të nenit 2 të kontratës ka marrë përsipër që t'ia paguaj kredinë në rast se kredimarrësi bie në vonesë në kthimin e kredisë. Po ashtu në nenin 3 pika 1 dhe 2 në po të njejtën kontratë është paraparë që dorëzani e autorizon kredithënësin që ta ngarkoj në të gjitha llogaritë e tij bankare të kredithënësi (tutje llogaritë) në emër të dorëzanit pa dhënë njoftim paraprak dorëzani me qëllim të përmbushjes së detyrimeve të dorëzanit ashtu si është përshkruar në këtë kontratë e për më tepër kjo kontratë është e nënshkruar nga palët në procedurë, rrjedhëmisht me nënshkrimin e kontratës për dorëzani nga paditësi është krijuar raporti obligativ nga kontrata për dorëzani, në këtë rast paditësi ka marrë obligimin që të përmbush obligimet nga kjo kontratë, kështu që paditësi i është shmangur ti ja paguaj shumën nga kontrata dhe më pas e paditura ka realizuar pagesën në bazë të nenit 3.2 të kontratës.

Nga të gjitha provat e administruara dhe nga pretendimet e palëve në procedurë si dhe nga përfaqësuesi ligjor i paditësit rezulton se paditësi me të vërtetë e kishte nënshkruar këtë kontratë dhe se me vullnetin e tij të plotë kishte garantuar për kredimarrësin ashtu si ka pohuar edhe vetë përfaqësuesi ligjor i paditësit në seancën e mbajtur të datës 21,09,2015 , andaj e paditura të drejtat e veta i ka mbështetur në kontratën mbi dorëzani dhe ka bërë transferimin e mjeteve nga xhirollogaria e paditësit.

Gjykata po ashtu vlerësoj edhe pretendimet tjera të paditësit lidhur me atë se nënshkrues i kontratës është B. U. e jo NTP "U." nga e cila janë transferuar një pjesë e të hollave, gjykata këtë pretendim e ka hudhur poshtë ngase NTP U. është e regjistruar si biznes individual ku pronar është B. U. tani paditësi nga e cila rezulton se biznesi individual ka përgjegjësi të pa kufizuara për të gjitha borxhet dhe detyrimet tjera të shkaktuara apo të imponuara nga një ligj apo kontratë duke përfshirë tërë pronën dhe asetet e cfarido lloji dhe kjo është e bazuar edhe në nenin 5 dhe 48 të Ligjit mbi Shoqëritë Tregtare çka do të thotë se pronari i këtij biznesi përgjigjet për të gjitha obligimet e krijuara me tërë pasurinë e vet, pra pasi që biznesi individual nuk ka subjektivitet juridik konsiderohet si pronë individuale të pronarit të saj B. U. dhe për obligimet e krijuara pronari përgjigjet me tërë pasurinë e tij, pra edhe me pasurinë që e ka në biznesin individual, kështu që e paditura të drejtën e vet e ka realizuar poashtu nga neni 3.1 e kontratës për dorëzani.

Ndërsa lidhur me anulimin e kontratës me të cilën ka kërkuar paditësi gjykata e vlerësoj si të pa lejuar sepse kontrata është e lidhur me vullnetin e palëve dhe nga personat me aftësi për të vepruar, që do të thotë se kontrata nuk është lidhur me kanosje e as në lajthim me të cilën do të mund të konsiderohet kontratë nule, meqenëse barra e provave në kontestet civile juridike në bazë të nenit 322 paragrafi 2 të LPK-së bie mbi palën e cila pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provoj faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, ndërsa në rastin konkret pala paditëse nuk e ka provuar një fakt të tillë, prandaj edhe gjykata ka vendosur vetëm në bazë të provave të cilat i ka patur në dispozicion. Gjykata për ti vërtetuar pretendimet e paditësi ka ndërgjuar edhe dëshmitarin H. B. por të njejtit nuk ja fali besimin pasi që i njejtë përveq mohimit të faktit se paditësi nuk ka ditur se cka ka nënshkruar nuk ka dhënë asnjë sqarim apo detaj tjetër për ta bërë deklartën e tij të besueshme, e aq më tepër ishte kontradikt me përfaqësuesin ligjor i cili asnjëherë nuk e ka kontestuar gjatë gjithë procedurës që ka pasur obligim t'ia paguaj shumën e cila ishte tërhequr nga e paditura.

Gjykata ka refuzuar me aktvendim propozimin lidhur me caktimin e ekspertit financiar për shkak të shkaktimit të dëmit ngase paditësi nuk ka paraqit prova dhe arsye me të cilën do ta argumentonte kërkesën e vet, ngase duke u bazuar në nenin 189 par.3 të LMD-së gjatë vlerësimit të shumës së përfitimit të munguar duhet të mirret në konsideratë fitimi që ka mundur të rritej në mënyrë të bazuar sipas procesit të rregullt të sendeve ose rrethanave të vecanta, ndërsa realizimi i të cilave është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga lëshimi që të ndërmarë veprimin, gjë që del se e paditura nuk ka shkaktuar dëm ashtu si është e paraparë në nenin e lartë cekur. Gjykata i shqyrtoi edhe provat dhe pretendimet të tjera të paditësit, por ato nuk ishin me ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje juridiko kontestimore.

Lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 451 par. 1 të LPK-së, në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i paditësit, i referohen shumës së përgjithshme të precizuar si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, e cila përfshin shpenzimet e kërkuara dhe të argumentuara nga paditësi dhe atë: për përgjigjie në padi shumën prej 208.00 €, për përfaqësime në 3 seanca (3X270 euro) shumën prej 810,00 € dhe për parashtresën e dt. shumën prej 208.00 €, që do të thotë në shumë të përgjithshme prej 1,226,00 €. ndërsa lidhur me vendosjen meritore të kësaj çështje juridike gjykata është bazuar në dispozitën e nenit 122 të LMD-së, si dhe në nenin 143 paragrafi 1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

-Departamenti për Çështje Ekonomike-
III.C.nr.394/2013, me dt;19.10.2015

Gjyqtarja
Franciska Zhitia-Ymeri

UDHËZIME JURIDIKE: Ndaj këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta e ankesës në afatin kohor prej 7 (shtatë) ditëve, duke llogaritur nga dita e pranimit të tij, duke iu drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.